



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A.
NJËSIA E SHËRBIMEVE TË BRËNDSHME MBËSHTETËSE
ADMINISTRATORI

Nr. 1036/prot.

Durrës më 09.11.2022

Lënda : Në përgjigje të shkresës tuaj nr.10360 prot, datë 28.10.2022.

AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve

TIRANË

Me shkresën tuaj nr.10360 prot, date 28.10.2022 në kuadër të bashkpunimit ndër -institucional kërkohet informacion për tre urat tona të cilat kanë nën-strukturë të përbashkët me rrjetin rrugor shqiptar.

Këto ura janë:

1. Ura mbi lumin Mat
2. Ura mbi lumin Kir
3. Ura e Rrogozhinës

Për sa më sipër ju bëjmë me dije:

Të tre urat e mësipërme janë pjesë e inventarit të Hekurudhës Shqiptare sh.a.

Për urën e Rrogozhinës me fondet e investimeve të vitit 2022, është lidhur kontrata për punë publike për ndërhyrje në nënstrukturën e urës, që konsiston në mbrojtjen e palankolave metalike të dy këmbëve të urës të zbuluara, për të mos lejuar gërryerjen dhe zbulimin e tyre të mëtejshëm, nëpërmjet disiplinimit të kinematikës së rrjedhjes së lumit Shkumbin dhe duke mos lejuar zgjerimin e shtratit të lumit, në afërsi të urës para dhe mbas saj.

Përsa i përket mbistrukturës së urës trarët dhe soletonet dhe pjesës tjetër të nënstrukturës, nuk mund të japin informacion mbi gjendjen teknike.

Për urën e Kirit dhe urën e Matit strukturat ekzistuese janë projektuar me standartet e vjetra sizmike, të cilat i vënë ato jashtë kuadrit të filozofisë së tanishme të projektimit dhe i bëjnë ato të

pamjaftueshme në lidhje me rregulloret moderne të sizmikës. Përmirësimi i përgjithshëm i klasave të tilla sizmike për strukturat e vjetra është praktikisht i pamundur dhe nuk rekomandohet në aspektin e kostos.

Për sa më sipër në kuader të transformimit të rrjetit hekurudhor shqiptar ura mbi lumin Mat dhe ura mbi lumin Kir do të bëhën të reja dhe për te cilat ka përfunduar Projekti i Zbatimit nga Konsulent SUEZ-IPF6 (WBIF/EBRD Grant), për projektin e rehabilitimi të linjës hekurudhore Vorë-Hani i Hotit.

Ju Faleminderit.

ADMINISTRATORI SHOQËRISË

Gentian LIKO

